

**VENDIM**  
**Nr.418, datë 27.4.2009**

**PËR NJOHJEN DHE PËRDORIMIN E LETËRNJOFTIMIT SI DOKUMENT**  
**IDENTIFIKIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3, 6 e 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, të pikave 4 e 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Institucionet, publike dhe jopublike, vendase dhe të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do ta njohin si dokument identifikimi letërnjoftimin, sipas modelit të paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Certifikata personale me fotografi do të përdoret si dokument identifikimi vetëm për shtetasit nën moshën 16 vjeç.

3. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, mbajnë shënim numrin personal dhe numrin e letërnjoftimit, si dhe mund të bëjnë fotokopje të letërnjoftimit të shtetasve, të cilëve u shërbejnë, nëse u nevojitet ky dokument si pjesë përbërëse e praktikës përkatëse.

4. Në rastet kur shtetasit nuk disponojnë letërnjoftim për arsye të justifikuara, lejohet përdorimi i certifikatës personale me fotografi, si dokument identifikimi, deri më 31 dhjetor 2009, në përputhje me dispozitat e parashikuara në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore.

5. Ndaj punonjësve të institucioneve, publike dhe jopublike, vendase, në rast të moszbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë vendim, do të merren masa disiplinore fillimisht me gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës, në rast përsëritjeje gjobë në vlerën e një page dhe nëse ripërsëritet pezullim nga detyra.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

